



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA KORÇË
DREJTORIA E AUDITIMIT TË BRENDSEHM

	Përmbajtja	Faqe
I.	Përmbledhje Ekzekutive	2
II.	Baza Ligjore	2-3
III.	Organizimi	3
	• Misioni i auditimit të brendshëm	3
	• Organizimi i NJAB	3
IV.	Rezultatet e Veprimtarisë së Auditimit të Brendshëm	3-11
	• Analiza e programeve të auditimit për periudhën raportuese	3-5
	• Analiza e misioneve të auditimit, objektivave të auditimeve.....	5
	• Fushat me risk të lartë dhe trajtimi i tyre	5-9
	• Gjetjet kryesore sipas sistemeve.....	9-11
	• Vlerësimi i sistemeve të kontrollit të brendshëm.....	11
	• Çështjet e dërguara për investigim.....	11
V.	Rekomandimet	11-14
	• Rekomandimet e propozuara	11-13
	• Përgjigjja dhe reagimet e menaxhimit	13-14
VI.	Monitorimi i Sistemit dhe Sigurimi i Cilësisë	14
VII.	Analiza e Kapaciteteve Audituese	14-15
	• Probleme të konstatuara në lidhje me funksionimin e NJAB	14
	• Kapacitetet audituese	15
	• Zhvillimi i aftësive dhe ngritja nivelit profesional të audituesve	15
	• Analiza e kostos dhe shpërndarja e burimeve	15
VIII.	Konkluzione	15-16
	• Konkluzione mbi problematikën e punës audituese	15
	• Prioritetet për vitin në vazhdim	16

**M I R A T O H E T
S O T I R A Q F I L O****KRYETAR I BASHKISË****I. Përmbledhje Ekzekutive**

Drejtoria e Auditimit të Brendshëm e Bashkisë Korçë, përcjell sipas kërkesave dhe standarteve të auditimit, Raportin e vitit 2020, për veprimtarinë e saj Janar- Dhjetor 2020, sipas detyrimit të pikës ç të nenit 14 të Ligjit nr. Nr. 114/2015 datë 22.10.2015 “Për auditimin e brendshëm në sektorin publik”.

Ky raport pasqyron përmbushjen nga Drejtoria të aktiviteteve të auditimit të realizuara për vitin 2020, në krahasimin me detyrimet e planifikuara dhe objektivat e caktuara.

Raporti gjithashtu siguron të dhëna statistikore të paraqitura në tabelat bashkëlidhur dhe të hartuara sipas formateve të unifikuara nga Drejtoria e Harmonizimit për AB, në Ministrinë e Financave, në Manualin e Auditimit të Brendshëm të miratuar me Urdhërin e Ministrit të Financave nr.100, date 25.10.2016 “Për miratimin e Manualit të Auditimit të Brendshëm në sektorin publik”, i ndryshuar, duke specifikuar një sërë treguesish të arritur, të dalë nga raportet e auditimeve të përfunduara për këtë vit.

Përveçse qëllimit raportues këta tregues të cilët pasqyrojnë performancën e punës së drejtorisë, do të jenë objekt i analizës së performancës, vlerësimit të cilësisë së shërbimit, etj për të siguruar një tendencë pozitive në rritje të treguesve në terma afatshkurtër e afatgjatë.

Të gjitha subjektet e audituara, i janë përgjigjur rekomandimeve të auditimit për korrigjimin e parregullsive, duke dëshmuar se ato kanë qënë të duhurat dhe se kanë ndihmuar në përmirësimin e menaxhimit dhe shtimin e vlerës së subjekteve publike.

Përpjekjet e Drejtorisë së Auditimit do të vijojnë për të përmbushur auditime me nivel të lartë profesional, duke realizuar qëllimet dhe objektivat vjetore dhe strategjike.

II. Baza Ligjore

Ligji nr. 114/2015 datë 22.10.2015 “Për auditimin e brendshëm në sektorin publik”.

Ligji nr. 9643 datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, me ndryshimet përkatëse.

Ligji nr. 10296 datë 08.07.2010 “Për menaxhimin Financiar dhe Kontrollin”.

Ligji nr.9936, datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”

Ligji për Buxhetin vjetor të shtetit dhe Udhëzimet e Ministrisë së Financave për zbatimin e tij.

Ligji nr.139/2015, datë 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore”.

Ligji nr.68/2017, datë 27.04.2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”.

Ligji nr.152/2013, datë 26.02.2014 “Për Nëpunësit Civil”, me ndryshime.

Ligji nr.9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore”, me ndryshimet përkatëse.

Ligji nr.7703, datë 11.05.1993 “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”,

Ligji nr.7870, datë 13.10.1994 “Për sigurimet shëndetësore në RSh”, me ndryshimet përkatëse.

Ligji nr.9136, datë 11.09.2003 “Për mbledhjen e kontributeve të detyrueshme të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore në Republikën e Shqipërisë”, me ndryshimet përkatëse.

VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

Udhëzim nr.30, datë 27.12.2011, “Për Menaxhimin e Aktiveve në Njësitë e Sektorit Publik”.

Manuali i Auditimit të Brendshëm, miratuar me urdhërin e MF nr.100, datë 25.10.2016 “Për miratimin e manualit të auditimit të brendshëm në sektorin publik”.

Kodi i etikës për AB në sektorin publik, miratuar me Urdhërin e Ministrit të Financave nr.86, dt.10.12.2015.

Karta e AB e bashkisë Korçë miratuar me urdhërin e kryetarit të bashkisë nr.631, dt.27.09.2017.

Programi për sigurimin e brendshëm të cilësisë të AB për bashkinë Korçë, miratuar me urdhërin e kryetarit të bashkisë nr.647, dt.17.10.2018

Të gjitha aktet ligjore dhe nënligjore të dala në zbatim të ligjeve të mësipërme.

Rregullorja e Bashkisë Korçë e miratuar nga kryetari i bashkisë për organizimin, funksionimin, detyrat dhe kompetencat e administratës së Bashkisë Korçë, si dhe të gjitha rregulloret e ndërmarrjeve dhe institucioneve të vartësisë.

III. Organizimi

- **Misioni i auditimit të brendshëm**

Misioni i auditimit të brendshëm është t’i japë siguri të arësyeshme kryetarit të Bashkisë, në mënyrë të pavarur dhe objektive, si dhe këshilla për përmirësimin e veprimtarisë dhe efektivitetin e sistemit të kontrollit të brendshëm në bashkinë Korçë dhe në institucionet e vartësisë, duke :

- Zbatuar standartet e auditimit dhe sigurimin e cilësisë.
- Dhënë rekomandime për përmirësimin e performancës dhe funksionimin e kontrollit të brendshëm.
- Vlerësuar dhe përmirësuar frytshmërinë e menaxhimit të riskut për fondet publike.
- Vlerësuar transparencën në përdorimin e fondeve e duke këshilluar menaxherët për të përmirësuar bashkëpunimin midis strukturave.
- Dhënë rekomandime për përmirësimin e sistemeve.
- Monitoruar, mbikqyruar, analizuar dhe vlerësuar auditimet e kryera.
- Parandaluar shkeljet e parregullsitë, zbuluar ato dhe duke ndihmuar menaxhimin në plotësimin e objektivave.

- **Organizimi i NJAB**

Në zbatim të gërmës a, pikës 1 të nenit Nr.10 të Ligjit Nr.114/2015, datë 22.10.20 “Për auditimin e brendshëm në sektorin publik” dhe të pikës 2 të nenit 43 të ligjit nr.139/2015, datë 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore” drejtorja e auditimit ka strukturë :

Drejtor	1
Auditues	3
Gjithsej	4 punonjës

Për vitin 2020 në këtë drejtori ka patur 1 drejtor dhe 1 auditues. Në krahasim me strukturën e miratuar, mbetet me 2 punonjës më pak.

Vartësia e njësisë së auditimit është nga Titullari i Institucionit (Kryetari).

Arsimi profesional i punonjësve është: 1 ekonomiste finance dhe 1 ekonomiste plani, në përputhje me kriteret e përcaktuara me përshkrimet e vendeve të punës që aplikohet për strukturat e auditimit. Drejtorja e kësaj Drejtorie dhe një audituese janë të çertifikuara.

Niveli profesional i drejtores dhe i një autiteje është shumë i mirë.

Njësia e Auditimit e shtrin auditimin në aktivitetin e drejtorive të Bashkisë, Institucionet dhe Nd-jet e vartësisë.

IV. Rezultatet e Veprimtarisë së Auditimit të Brendshëm

- **Analiza e programeve të auditimit për periudhën raportuese**

Për vitin 2020, pas rishikimit 2 herë të planit vjetor të miratuar nga kryetari i bashkisë në dt.08.10.2020 dhe në dt.04.11.2020, janë planifikuar 6 auditime gjithësej dhe janë realizuar 6 auditime sipas tabelës :

NR	SUBJEKTI I AUDITUAR	REALIZIMI po/jo	SHPJEGIME
1	BASHKIA -Drejtoria e prokurimeve	Po	
2	Qendra ditore e riaftësimit.	Po	
3	Shoqëria "Qendra Sportive Korçë"sh.a	Po	
4	NShP "Projekti me fonde të ambasadës Japoneze"	Po	
5	BASHKIA - Drejtoria e kontroll territorit, për subjektin TOME GAZ	Po	
6	BASHKIA-Financa për detyrimet e prapambetura	Po	
	TOTALI	6	

Në fund të periudhës 9 mujore, duke parë ecurinë e angazhimeve të zhvilluara, i është kërkuar kryetarit të bashkisë të miratojë ndryshimin e planit fillestar të auditimeve, i cili ka miratuar ndryshimet në dt.08.10.2020 dhe në dt.04.11.2020.


Ndryshimet e planit të angazhimeve për vitin 2020, janë dërguar në Drejtorinë e Harmonizimit të AB me shkresat nr.7848, dt.15.10.2020 dhe nr.7848/1, dt.15.12.2020.

Arësyet e rishikimit të planit fillestar dhe ndryshimi i tij për vitin 2020, kanë qënë :

- Situatën e pandemisë KOVID 19
- Auditimin e veprimtarisë të bashkisë Korçë nga KLSH për një kohë të gjatë, nga 04.03.2020 – 06.11.2020, nga dy grupe të ndryshme auditimi
- Shkresa e Drejtorisë së Harmonizimit të AB në MFE me nr.19310, dt.16.10.2020, mbërritur në bashki me nr.8432 prot., dt.30.10.2020, për kryerjen e angazhimit të auditimit të detyrimeve financiare të prapambetura, brënda vitit 2020, për detyrimet e raportuara deri në dt.30 shtator 2020.

Auditimi i parashikuar në planin fillestar për drejtorinë e Burimeve Njerëzore është zhvendosur për tu realizuar në vitin pasardhës.

Në grafikun e mëposhtëm jepet një realizim i auditimeve të planifikuara në tre vitet e fundit, 2018-2019-2020



Arësytet e ndryshimeve të planit vjetor në këto tre vite kanë ardhur për arsye të :

1. Mbivendosjes së auditimeve të planifikuara me auditimin e jashtëm KLSH.
2. Mungesës së plotësisë të njësisë me auditues sipas strukturës së miratuar.
3. Kërkesave të titullarit për auditime të paparashikuara në planin vjetor.
4. Problematikës së shfaqur rishtazi për shkak të reformës territoriale.
5. Njohjes e përditësimit të ndryshimeve të bazës ligjore, sidomos për Vetëqeverisjen vendore, MFK dhe Auditimin e Brendshëm.
6. Situata e pandemisë COVID-19, në vitin 2020

- **Analiza e misionëve të auditimit**

Për vitin 2020, janë kryer gjithsej 6 angazhime auditimi, 3 angazhime përputhshmërie, 1 angazhim performace dhe 2 angazhime me kërkesë të titullarit.

Janë evaduar 5 raporte auditimi dhe një raport është në proces Pasqyra nr.2 bashkëngjitur këtij raporti jep realizimin e planit të angazhimeve për vitin 2020.

- **Fushat me risk të lartë dhe trajtimi i tyre**

Për vitin 2020 angazhimit e auditimit janë përqëndruar kryesisht në fushën e prokurimeve, shlyerjes së detyrimeve financiare të prapambetura të bashkisë, fushën e procedurave për dhënien e licencave për karburante, fushën e kujdesit social në Qendrën ditore të riaftësisë, zbatimin nga NSHP të detyrimeve kontraktore të projektit të financuar nga ambasada japoneze në Tiranë për blerjen e makinerive të nevojshme për mbrojtjen e mjedisit dhe mirëmbajtjen e sipërfaqeve të gjelbërta dhe në shoqërinë aksionere “Qendra Sportive Korçë”.

Vlerësimi i riskut për këto fusha në vitin 2020 ka qënë :

- Prokurimet në drejtorinë e bashkisë – risku i lartë
- Qendra ditore e riaftësisë – risku i mesëm
- Shoqëria “Qendra sportive Korçë” sh.a – risku i lartë
- NSHP për projektin me fondet Japoneze – risku i mesëm
- Drejtoria e Kontroll territorit në bashki, licenca për subjektin TOME GAZ – i mesëm
- Shlyerja e detyrimeve financiare të prapambetura të bashkisë – risku i lartë.

Nga auditimet e kryera ka rezultuar si vijon :

- Fusha e Prokurimeve Publike, vazhdon të mbetet një fushë me risk të lartë për shkak të numurit të shumtë të procedurave të zhvilluara dhe të ndryshimeve ligjore. Kanë rezultuar mangësi :
Në ndryshimet e shpeshta të rregjistrit të parashikimeve;
Në unifikimin e mënyrave të llogaritjes së nevojave për mallra e shërbime nga institucionet e vartësisë për procedurat që zhvillohen të përqëndruara nga bashkia;
Në zhvillimin e konkurseve të projektimit për investimet me vlera të konsiderueshme dhe me natyra ndërtimore specifike, sipas kërkesave ligjore, neni 35 i ligjit nr.9643, dt.20.11.2006 "Për prokurimin publik", i ndryshuar.
Në mungesën e dokumentacionit justifikues që duhet të mbajnë grupet e punës të ngritur nga kryetari për argumentimin e cmimeve të vendosura në preventiv, për zërat e punimeve që nuk përfshihen në manualin teknik të cmimeve;
Në argumentimin dhe dokumentimin e përllogaritjes së vlerës të kontratës, bazuar në specifikimet teknike, përpara nxjerrjes së urdhërit të prokurimit;
Në verifikimin nga Njësia e prokurimit të llogaritjes së vlerës të kontratës për të shmangur mospërputhjet në emërtime dhe në cmime të zërave në preventiv me cmimet në manualin teknik të punimeve të ndërtimit;

Në hartimin e gjurmëve specifike të auditimit për menaxhimin e aktiveve, referuar gjurmëve standarte bashkëlidhur Udhëzimit nr. 30, dt.27.12.2011 të MF dhe për prokurimet, referuar pikës 3 të Urdhërit nr.57, 12.6.2014 “Gjurmët standarte të auditit për prokurimin me vlerë të madhe dhe të vogël”;

Në përcaktimin nga Njësia e prokurimit të kriterëve për kualifikim në përputhje me kërkesat e cilësuar në specifikimet teknike, si dhe përcaktimin e dokumentacionit të duhur që duhet të paraqitet nga operatorët ekonomikë, për përmbushjen e kriterëve të veçanta për kualifikim;

Në respektimin nga KVO të afatit ligjor për vlerësimin e ofertave, sipas rastit 15 ditë për procedurën e hapur dhe 5 ditë për procedurën Kërkesë për propozim;

Në studimin dhe dokumentimin me detaje të kërkesave të sipërmarrësit për ndryshime në zërat e punimeve të preventivit fitues, pasi ndryshimet e miratuara për objektin « Sistemime malore » 2018, kanë ndryshuar dukshëm kushtet bazë të përzgjedhjes së sipërmarrësit, veprim i cili vjen në kundërshtim me DST, shtojca 18, Kushtet e përgjithshme të kontratës, pika 35.1 e nenit 35 Negociatat dhe amendamentet.

- Institucioni i vartësisë, Qendra Ditore e riaftësisë, që ofron shërbime në fushën e kujdesit social, ka rezultuar me mangësi në:

Zbatimin e komponentëve të kontrollit të brendshëm si rregullorja e funksionimit, identifikimi i riskut dhe strategjia për menaxhimin e tij, aktivitetet e kontrollit, funksionimi i sistemit të informacionit e komunikimit dhe monitorimi i aktiviteteve;

Respektimin e kërkesave të pikës 2.2 të rregullores ku citohet : “*Konkurimi afrohet nga drejtuesi i institucionit në Bashki, ku jepen të dhënat për vendin e lirë të punës si dhe kushtet për të zënë këtë vend pune*”;

Zbatimin me përpikmëri të kërkesave të V.K.M-së nr.914, dt. 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” kreu IV, neni 40, pika 1 dhe pika 8, dhe kërkesat e Udhëzimit të APP-së nr.3, dt.08.01.2018 “Mbi përdorimin e procedurës së prokurimit me vlera të vogla” pika 3, për të prokuruar ose parashikuar procedura prokurimi për blerjen e një grupi mallrash, kryerjen e shërbimeve apo punëve të ngjashme, që kanë të njëjtin funksion kryesor apo kanë të njëjtin emërtim në planin e shpenzimeve.

Planifikimin e detajuar të shpenzimeve dhe ndarjen në zëra, për të gjithë fondin e çelur për shpenzime.

Regjistrimet në ditarët e magazinës të cilët nuk përmbajnë të gjitha elementët e përcaktuar në pikën 2 të nenit 7 të Ligjit nr.25/2018, datë 10.05.2018 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”, (origjina, natyra, data, përmbajtja).

Hartimin e rregullave për menaxhimin e aktiveve, në zbatim të pikës 5, Kapitulli I i Udhëzimit Nr. 30 Datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik” dhe Neni 8, pika 8, germa (ç) e Ligjit Nr.10296, datë 08.07.2010 “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin”.

Hartimin e bilancit verifikues paraprak, pas regjistrimeve të kryera në mënyrë kronologjike në ditarët e kontabilitetit, kryerjes së procedurat të rakordimit, sistemit të diferencave dhe veprimeve të mbylljes së llogarive deri në nxjerrjen e pasqyrave financiare përfundimtare.

Risku për këtë fushë edhe pas auditimit mbetet i mesëm.

- Shoqëria “Qendra Sportive Korçë” sh.a, një institucion relativisht i ri i krijuar në vitin 2017, ofron shërbime në fushën e sportit e kulturës dhe administron pronat e bashkisë që i takojnë këryre sferave. Shoqëria ka rezultuar me mangësi në:

Zbatimin e komponentëve të kontrollit të brendshëm si rregullorja e funksionimit, identifikimi i riskut dhe strategjia për menaxhimin e tij, aktivitetet e kontrollit, funksionimi i sistemit të informacionit e komunikimit dhe monitorimi i aktiviteteve;

Përgatitjen e raportit për ecurinë e veprimtarisë dhe të pasqyrave financiare vjetore, mbështetur në nenin 134/2 i ligjit nr. 9901, datë 14.4.2008 “Për tregëtarët dhe shoqëritë tregëtare”, ku të përfshihet deklarata e miradministrimit (një dokument shpjegues), ku trajtohen e shpjegohen parimet e rregullat e miradministrimit dhe të drejtimit të brendshëm të shoqërisë; praktikat që ndiqen në zbatim të ligjit nr. 9901, datë 14.4.2008 “Për tregëtarët dhe shoqëritë tregëtare” dhe profili i administratorit dhe anëtarëve të këshillit mbikqyrës, shpjegimi pse këta individë janë të kualifikuar për të kryer detyrat e caktuara.

Protokollimin e njoftimit me shkresë për thirrjen e Asamblesë së përgjithshme dhe rendin e ditës, jo me vonë se 21 ditë përpara datës së parashikuar për mbledhjen e asamblesë, në zbatim të nenit 137 ligjit nr. 9901, datë 14.4.2008 “Për tregëtarët dhe shoqëritë tregëtare”. Rendi i ditës i njoftuar sipas nenit 137 , të përmbajë edhe vendimet e propozuara për çdo çështje.

Hartimin nga administratorët dhe miratimin nga Asambleja e Përgjithshme, e skemës së shpërblimeve për ekspertët kontabël të autorizuar, në zbatim të nenit 135 pika 2 germa d e ligjit nr. 9901, datë 14.4.2008 “Për tregëtarët dhe shoqëritë tregëtare”.

Nënshkrimin nga të gjithë anëtarët e këshillit mbikqyrës të dokumenteve që i paraqiten asamblesë së përgjithshme (pasqyrat financiare vjetore, raportet e ecurisë së veprimtarisë, raportimet e tjera), referuar nenit 154/e të ligjit nr. 9901, datë 14.4.2008 “Për tregëtarët dhe shoqëritë tregëtare”.

Hartimin e Raportit nga Këshilli Mbikqyrës i cili të përmbajë edhe mendimin për raportin e auditimit të pasqyrave financiare, referuar nenit 154/e të ligjit nr. 9901, datë 14.4.2008 “Për tregëtarët dhe shoqëritë tregëtare”.

Planifikimin e detajuar të të ardhurave sipas burimit të krijimit të tyre.

Planifikimin e mirëstudiuar të shpenzimeve dhe shpërndarjen e fondeve duke pasur parasysh kërkesat dhe realizimin e tyre në vitin e mëparshëm. Planifikimin në zë të veçantë për pagesën e këshillit mbikqyrës dhe saktësinë në planifikim të llogaritjes së kontributeve shoqërore e shëndetsore të punëdhënësit, në masën 16.7% mbi fondin e pagës bruto.

Parashkrimin e nenit 7, pika 7.2 e kontratës, për subjektet “Ina Toci” dhe “ISTC media”, që ka lidhje me arkëtimin e të ardhurave me vlera më të vogla se 1000 lek, të bëhet bazuar në udhëzimin nr.30, datë 27.12.2011, “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, pika 64.

Pagesat e qirave për subjektet qiramarrëse në afatet e përcaktuara në kontrata dhe aplikimin e penalteteve në të gjitha rastet e pagesës me vonesë të tyre, kamatën ditore në masën 1% për çdo ditë vonesë ditore, mbi vlerën e qerasë mujore, si është parashikuar në pikën 6.3 të nenit 6 të kontratës së lidhur midis palëve.

Dokumentimin e monitorimit të zbatimit të kontratave, pasi nuk është mbajtur proces verbal gjatë kontrollit të detyrimeve kontraktore për cilësinë e kërkuar sipas specifikimeve teknike e dokumentacionit të tenderit, në kundërshtim me pikën 2, Kreun VIII të V.K.M.nr.1, dt.10.01.2007 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

Regjistrimet në ditarët e magazinës të cilët nuk përmbajnë të gjitha elementët e përcaktuar në pikën 2 të nenit 7 të Ligjit nr.25/2018, datë 10.05.2018 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”, (origjina, natyra, data, përmbajtja).

Krijimin e regjistrit të aktiveve që zotëron shoqëria, duke përfshirë në të edhe pronat publike nga të cilat siguron të ardhura në zbatim të pikës 31/c të Udhëzimit nr.30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”.

Hartimin e rregullave për menaxhimin e aktiveve, në zbatim të pikës 5, Kapitulli I i Udhëzimit nr. 30, dt 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik” dhe nenit 8, pika 8, germa (ç) e Ligjit Nr.10296, datë 08.07.2010 “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin”.

Pasqyrimin në aktiv të bilancit të gjendjes së biletave të pashitura (në magazinë), me vlerën e drejtë të tyre (koston e blerjes), bazuar në Shtojca 1 – “Zërat e Bilancit” të Standartit Kombëtar të Kontabilitetit Nr. 2“Paraqitja e pasqyrave financiare”.

Plotësimin e rregjistrimit themeltar dhe librit të pagave për punonjësit sipas formatit, pika 2 e V.K.M nr. 594 date 22.12.1997 “Për regjistrin që mban punëdhënësi për punëmarrësin e tij”.

Për shkak të personelit të ri që drejton shoqërinë dhe njohjes së kufizuar të legjislacionit në këtë fushë, shoqëria edhe pas auditimit mbetet me risk të lartë.

- Ndërmarrja e Shërbimeve Publike për projektin e blerjes së makinerive të nevojshme për mbrojtjen e mjedisit dhe mirëmbajtjen e sipërfaqeve të gjelbërta, me fonde të ambasadës japoneze në Tiranë. Nuk rezultuan mangësi në zbatimin e marrëveshjes në nënshkruar me donatorin. Vetëm dy tematika u trajtuan :
Njoftimi i donatorit për përfundimin e ekzekutimit të projektit.
Miratimin e rregullave për lëvizjen e shkresave nëpërmjet zyrës së arkivit të ndërmarrjes, në zbatim të detyrimeve ligjore të ligjit nr. 9154, dt.06.11.2003 “Për arkivat” dhe “Normave tekniko-profesionale dhe metodologjike të shërbimit Arkivor në Republikën e Shqipërisë”, të përcaktuara nga Drejtoria e Përgjithshme e Arkivave.
- Drejtorja e Kontroll territorit, për vlerësimin e detyrimit tatimor të subjektit Tome Gaz në lidhje me licensën e dhënë nga bashkia Korçë për këtë subject si stacioni i tregëtimit me shumicë e pakicë të karburanteve. Nga verifikimi i procedurës dhe pagesave të kryera nga subjekti rezultoi se ish-in zbatuar të gjitha kërkesat e VKM nr.344, dt.19.04.2017. Subjekti është pajisur me licensën përkatëse me nr.2471/1, dt.08.11.2017, me afat 5 vjet, bazuar në fushën e aktivitetit të tij të tregëtisë si Sh.p.k, për të cilën ka paguar dhe detyrimin tatimor prej 1.000.000 (një milion) lek. Pretendimi i subjektit se detyrimi i tij duhej të ishte vetëm 100.000 (njëqin mijë) lek nuk qëndron, pasi vjen në kundërshtim me kërkesat e VKM-së më sipër.
- Fusha e shlyerjes së detyrimeve financiare të prapambetura, për të cilën janë kryer angazhime auditimi edhe në 2 vitet e mëparshme, ka pasur përmirësime të dukshme.
Detyrimet e mbetura në fund të 9 mujorit të vitit 2020 për shumën **55.860.054 lek**, i takojnë në masën më të madhe detyrimeve të krijuara gjatë vitit 2019 dhe gjatë vitit 2020.
Në përfundim të angazhimit kanë rezultuar mëngësi në:
Përcaktimin e risqet kryesore në fushën e detyrimeve financiare të prapambetura, mbi bazën e të cilave të hartohet dhe plani veprimit për minimizimin e tyre.
Përditësimin e rregullores së funksionimit të drejtorisë në lidhje me detyrat e përgjegjësitë e cdo punonjësi për detyrimet financiare të prapambetura.
Përcaktimin në mënyrë të qartë të arsyeve për detyrimet e prapambetura, të pashlyera përpara vitit 2019 dhe planifikimin me përparësi të shlyerjes së tyre.
Respektimin me saktësi në shlyerjen e detyrimeve të prapambetura sipas parimit të radhës kohore të krijimit të detyrimeve, pasi në rastin e Mbetjeve të përziera, fatura e muajit janar 2020 është likuiduar më parë se fatura e muajit dhjetor 2019, që rezulton në listën e detyrimeve e palikuiduar.
Dërgimin në APP të kërkesës për përjashtimin e kontraktorit nga pjesëmarrja në prokurimet publike brenda 3 (tre) muajve nga zgjidhja e kontratës, në rast të mospërmbyesjes së detyrimeve kontraktore, të zbatohet Neni 77, Kreu IX, VKM 914/2014 dhe pika 3/ç e nenit 13 LPP për vendosje penaliteti. Mbajtjen e sigurimit të kontratës në rast moszbatim kontrate nga kontraktori dhe në rast shtyrje të afatit të zbatimit të kontratës, mbulimin me sigurim kontrate të shtyrjes së afatit të deklaruar të kontratës.
Risku për këtë fushë edhe pas auditimit mbetet i lartë.

Nga analiza e treguesve rezulton se është rritur eficiency e veprimtarisë audituese. Rezultatet e këtij raporti mbështesin konkluzionin për një rritje të dukshme të performancës dhe cilësisë së veprimtarisë audituese në plotësimin e misionit të saj të ngarkuar me ligj, si dhe në përqëndrimin e kohës më të madhe të auditimit, tek fushat me risk të lartë dhe tek trajtimi i tyre.

- **Gjetjet kryesore sipas sistemeve**

Natyrë e rekomandimeve i referohet gjetjeve dhe karakteristikave të njësive të audituara, të cilat janë të detajuara në pasqyrat nr.3 dhe nr.4 bashkëlidhur raportit. Gjetjet e auditimit i referohen parregullsisë, shkeljeve dhe mangësive në të gjitha fushat e audituara si: Drejtoria e prokurimeve, Qendra ditore e riaftësimit, Shoqëria “Qendra sportive Korçë” sh.a, NShP për projektin me fonde të ambasadës japoneze, Drejtoria e kontroll teritorit për licensimin e subjektit Tome Gaz dhe Drejtoria e financës për shlyerjen e detyrimeve financiare të prapambetura,

Gjetjet sipas fushave të mësipërme janë grupuar në sistemet e :

- Sistemi i Prokurimeve blerjeve dhe investimeve për :

Hartimin e rregullave për minimizimin e ndryshimeve të rregjistrimit të parashikimit të prokurimeve.

Unifikimin e mënyrës së llogaritjes së nevojave për mallra e shërbime nga institucionet e vartësisë, për procedurat e prokurimit të përqëndruara, që kryhen nga bashkia.

Zhvillimin e konkurseve të projektimit për investimet me vlera të konsiderueshme dhe me natyrë ndërtimore specifike.

Të kërkohet nga njësia e prokurimit, dokumentacioni justifikues i mbajtur nga grupet e punës të ngritur me urdhër të kryetarit, për argumentimin e cmimeve të vendosura në preventiv me analiza cmimesh, për zërat e punimeve që nuk përfshihen në manualin teknik të cmimeve të miratuar me VKM.

Argumentimin dhe dokumentimin përlllogaritja e vlerës së kontratës, bazuar në specififikimet teknike, përpara nxjerrjes së urdhërit të prokurimit.

Verifikimin nga njësia e prokurimit e llogaritjes së vlerës së kontratës për të shmangur mospërputhjet në emërtime dhe në cmime të zërave në preventiv me cmimet në manualin teknik të punimeve të ndërtimit.

Hartimin e gjurmëve specifike të auditimit për menaxhimin e aktiveve, referuar gjurmëve standarte.

Përcaktimin e kriterëve për kualifikim në përputhje me kërkesat e cilësuar në specififikimet teknike, si dhe përcaktimin e dokumentacionit të duhur që duhet të paraqitet nga operatorët ekonomikë, për përmbushjen e kriterëve të veçanta për kualifikim.

Respektimin nga KVO të afatit ligjor për vlerësimin e ofertave, sipas rastit 15 ditë për procedurën e hapur dhe 5 ditë për procedurën Kërkesë për propozim.

Studimin dhe dokumentimin me detaje të kërkesës së sipërmarrësit për ndryshime në zërat e punimeve të preventivit fitues, për të mos ndryshuar dukshëm kushtet bazë të përzgjedhjes së sipërmarrësit.

Përcaktimin e risqeve kryesore në fushën e detyrimeve financiare të prapambetura.

- Sistemi i përkujdesjes shoqërore për :

Përditësimi i rregullores së Qendrës Ditore të riaftësimit

Ushtrimi i kontroleve mbi ngjarjet që rrezikojnë realizimin e objektivave.

Dokumentimi i veprimtarive të kontrollit për vlerësimin e treguesve të performancës.

Miratimi dhe vënia në funksion e sistemit të informacionit dhe komunikimit.

Hartimi i programit për monitorimin e aktiviteteve dhe raportimi i mangësive.

Respektimi i kërkesave të rregullores për konkurimin në vendet e lira të punës nga kryetari i bashkisë.

Zbatimin e procedurave të prokurimit për blerjen e grup mallrave, shërbimeve apo punëve të ngjashme.

Planifikim të detajuar të zërave për të gjithë fondin e shpenzimeve.

Rregjistrimin në ditarët e kontabilitetit të të gjithë elementeve që përcakton ligji për kontabilitetin.

Hartimin e rregullave për menaxhimin e aktiveve.

Hartimin e bilancit verifikues paraprak.

- Sistemi i tatim taksave për : s'ka

- Sistemi i administrimit të pronës dhe pasurisë për :
 - Përditësimi** i rregullores së shoqërisë Qendra Sportive Korçë sh.a
 - Ushtrimi** i kontrolleve mbi ngjarjet që rrezikojnë realizimin e objektivave të shoqërisë Qendra Sportive Korçë sh.a
 - Dokumentimi** i veprimtarive të kontrollit për vlerësimin e treguesve të performancës të shoqërisë Qendra Sportive Korçë sh.a
 - Miratimi dhe vënia** në funksion e sistemit të informacionit dhe komunikimit të shoqërisë Qendra Sportive Korçë sh.a
 - Hartimi** i programit për monitorimin e aktiviteteve dhe raportimi i mangësive të shoqërisë Qendra Sportive Korçë sh.a
 - Përfshirja** e deklaratës së miradministrimit në analizen vjetore të pasqyrave financiare të shoqërisë Qendra Sportive Korçë sh.a.
 - Miratimi** nga Asambleja të skëmës së shpërblimit për ekspertët kontabël.
 - Protokollimi** e njoftimit për thirrjen e asamblesë në afatin e përcaktuar nga ligji, së bashku me vendimet e propozuara për cdo çështje.
 - Nënshkrimi** nga këshilli mbikqyrës të dokumentave që i paraqiten asamblesë.
 - Hartimi** nga keshilli mbikqyrës i raportit për vlerësimin e auditimit të pasqyrave financiare.
 - Planifikimi** i të ardhurave të shoqërisë të detajuar sipas burimit të krijimit.
 - Planifikimi** i shpenzimeve dhe shpërndarjen e fondeve duke pasur parasysh kërkesat dhe realizimin e tyre në vitin e mëparshëm.
 - Planifikimi** në zë të veçantë për pagesën e këshillit mbikqyrës dhe saktësinë në planifikim të llogaritjes së kontributeve shoqërore e shëndetsore të punëdhënësit, në masën 16.7% mbi fondin e pagës bruto.
 - Parashkrim** i qartë në nenet e kontratës, për subjektet “Ina Toci” dhe “ISTC media”, që ka lidhje me arkëtimin e të ardhurave me vlera më të vogla se 1000 lek.
 - Pagesa** e qirasë për subjektet qiramarrëse në afatet e përcaktuara në kontrata dhe aplikimin e penalteteve në të gjitha rastet e pagesës me vonesë të tyre, kamatën ditore në masën 1% për çdo ditë vonesë ditore, mbi vlerën e qerasë mujore.
 - Dokumentimi** i monitorimit të zbatimit të kontratave, pasi nuk është mbajtur proces verbal gjatë kontrollit të detyrimeve kontraktore për cilësinë e kërkuar sipas specifikimeve teknike e dokumentacionit të tenderit.
 - Rregjistrimi** në ditarët e kontabilitetit të të gjithë elementeve që përcakton ligji për kontabilitetin.
 - Hartimi** i rregjistrimit të aktiveve.
 - Hartimi** i rregullave për menaxhimin e aktiveve.
 - Plotësimi** i rregjistrimit themeltar dhe librit të pagave për punonjësit e shoqërisë.

- Sistemi i konfirmimeve të tjera me karakter organizativ :
 - Përditësimi** i rregullores së funksionimit të drejtorisë së financës në lidhje me detyrat e përgjegjësitë e cdo punonjësi për detyrimet financiare të prapambetura.

Përcaktimi në mënyrë të qartë i arsyeve për detyrimet e prapambetura, të pashlyera përpara vitit 2019 dhe planifikimin me përparësi të shlyerjes së tyre.

Respektimi me saktësi në shlyerjen e detyrimeve të prapambetura sipas parimit të radhës kohore të krijimit të detyrimeve, pasi në rastin e Mbetjeve të përziera, fatura e muajit janar 2020 është likuiduar më parë se fatura e muajit dhjetor 2019, që rezulton në listën e detyrimeve e palikuiduar.

Dërgimi në APP i kërkesës për përjashtimin e kontraktorit nga pjesëmarrja në prokurimet publike brenda 3 (tre) muajve nga zgjidhja e kontratës, në rast të mospërbushjes së detyrimeve kontraktore, të zbatohet Neni 77, Kreu IX, VKM 914/2014 dhe pika 3/ç e nenit 13 LPP për vendosje penaliteti. Mbajtjen e sigurimit të kontratës në rast moszbatim kontrate nga kontraktori dhe në rast shtyrje të afatit të zbatimit të kontratës, mbulimin me sigurim kontrate të shtyrjes së afatit të deklaruar të kontratës.

Miratimi i rregullave për lëvizjen e shkresave nëpërmjet zyrës së arkivit të ndërmarrjes, në zbatim të detyrimeve ligjore të ligjit nr. 9154, dt.06.11.2003 “Për arkivat” dhe “Normave tekniko-profesionale dhe metodologjike të shërbimit Arkivor në Republikën e Shqipërisë”, të përcaktuara nga Drejtoria e Përgjithshme e Arkivave.

- Sistemi i konfirmimeve të tjera :

Njoftimi i donatorit, ambasadës japoneze, për përfundimin e ekzekutimit të projektit ng NSHP.

Për vitin 2020, nuk janë evidentuar gjetje me dëm ekonomik.

- **Vlerësimi i sistemeve të kontrollit të brendshëm.**

Për vitin 2020, në të gjitha subjektet e audituara është bërë kryesisht vlerësimi i funksionimit të kontrollit të brendshëm, procedurave të vendosura për funksionimin e mirë të këtyre sistemeve.

Vlerësimi i kontrollit të brendshëm është përqëndruar tek procedurat e vendosura dhe të zbatuara për sistemin e menaxhimit të burimeve njerëzore, sistemin e pagesave, procedurat e prokurimit dhe administrimin e procesit të prokurimit, planifikimin e saktë të të ardhurave nga fushat e audituara, administrimin e pasurive, ndarjen e detyrave e përgjegjësive për çdo punonjës, rregullat për kontrollin dhe monitorimin e punës së cdo punonjësi, identifikimin e risqeve dhe aktivitetet e kontrollit të vendosura për uljen e tyre, përgatitjen e regjistrit të riskut nga cdo strukturë, vendosjen e linjave të komunikimit e raportimit për ndjekjen e realizimit të objektivave.

- **Çështjet e dërguara për investigim.**

Gjatë vitit 2020 njësia e AB e Bashkisë Korçë nuk ka dërguar asnjë çështje për investigim.

V. Rekomandimet

- **Rekomandimet e propozuara**

Gjatë vitit 2020 janë zhvilluar gjithësej 6 angazhime auditimi. Natyra e rekomandimeve i referohet gjetjeve dhe karakteristikave të njësive të audituara, të cilat janë të detajuara në pasqyrën nr.5 bashkëlidhur raportit.

Gjetjet e auditimit i referohen parregullsisve, shkeljeve dhe mangësive në fushat e audituara. Rekomandimet janë dhënë kryesisht në përmirësimin e :

- *Sistemit të prokurimeve, blerjeve e investimeve nëpërmjet*

Hartimit të rregullave për minimizimin e ndryshimeve të regjistrit të parashikimit të prokurimeve.

Unifikimin e mënyrës së llogaritjes së nevojave për mallra e shërbime nga institucionet e vartësisë, për procedurat e prokurimit të përqëndruara, që kryhen nga bashkia.

Zhvillimit të konkurseve të projektimit për investimet me vlera të konsiderueshme dhe me natyra ndërtimore specifike.

Të kërkohet nga njësia e prokurimit, dokumentacioni justifikues i mbajtur nga grupet e punës të ngritur me urdhër të kryetarit, për argumentimin e cmimeve të vendosura në preventiv me analiza cmimesh, për zërat e punimeve që nuk përfshihen në manualin teknik të cmimeve të miratuar me VKM.

Argumentimit dhe dokumentimit të përllogaritjes së vlerës së kontratës, bazuar në specifikimet teknike, përpara nxjerrjes së urdhërit të prokurimit.

Verifikimit nga njësia e prokurimit të llogaritjes së vlerës së kontratës për të shmangur mospërputhjet në emërtime dhe në cmime të zërave në preventiv me cmimet në manualin teknik të punimeve të ndërtimit.

Hartimit të gjurmëve specifike të auditimit për menaxhimin e aktiveve, referuar gjurmëve standarte.

Përcaktimit të kriterëve për kualifikim në përputhje me kërkesat e cilësuar në specifikimet teknike, si dhe përcaktimin e dokumentacionit të duhur që duhet të paraqitet nga operatorët ekonomikë, për përmbushjen e kriterëve të veçanta për kualifikim.

Respektimit nga KVO të afatit ligjor për vlerësimin e ofertave, sipas rastit 15 ditë për procedurën e hapur dhe 5 ditë për procedurën Kërkesë për propozim.

Studimit dhe dokumentimit me detaje të kërkesës së sipërmarrësit për ndryshime në zërat e punimeve të preventivit fitues, për të mos ndryshuar dukshëm kushtet bazë të përzgjedhjes së sipërmarrësit.

Përcaktimit të risqeve kryesore në fushën e detyrimeve financiare të prapambetura.

- *Sistemit të përkujdesjes shoqërore nëpërmjet*

Përditësimit të rregullores së Qendrës Ditore të riaftësimit

Ushtrimit të kontrolleve mbi ngjarjet që rrezikojnë realizimin e objektivave.

Dokumentimit të veprimtarive të kontrollit për vlerësimin e treguesve të performancës.

Miratimit dhe vënies në funksion të sistemit të informacionit dhe komunikimit.

Hartimit të programit për monitorimin e aktiviteteve dhe raportimi i mangësive.

Respektimit të kërkesave të rregullores për konkurimin në vendet e lira të punës nga kryetari i bashkisë.

Zbatimit të procedurave të prokurimit për blerjen e grup mallrave, shërbimeve apo punëve të ngjashme.

Planifikimit të detajuar të zërave për të gjithë fondin e shpenzimeve.

Rregjistrimit në ditarët e kontabilitetit të të gjithë elementeve që përcakton ligji për kontabilitetin.

Hartimit të rregullave për menaxhimin e aktiveve.

Hartimit të bilancit verifikues paraprak.

- *Sistemit të administrimit të pronës e pasurisë nëpërmjet*

Përditësimit të rregullores të shoqërisë Qendra Sportive Korçë sh.a.

Ushtrimit të kontrolleve mbi ngjarjet që rrezikojnë realizimin e objektivave të shoqërisë.

Dokumentimit të veprimtarive të kontrollit për vlerësimin e treguesve të performancës së shoqërisë.

Miratimit dhe vënies në funksion të sistemit të informacionit dhe komunikimit të shoqërisë.

Hartimit të programit për monitorimin e aktiviteteve dhe raportimi i mangësive të shoqërisë.

Përfshirjes së deklaratës së miradministrimit në analizen vjetore të pasqyrave financiare të shoqërisë Qendra Sportive Korçë sh.a.

Miratimit nga Asambleja të skemës së shpërblimit për ekspertët kontabël.

Protokollimit të njoftimit për thirrjen e asamblesë në afatin e përcaktuar nga ligji, së bashku me vendimet e propozuara për cdo çështje.

Nënshkrimin nga këshilli mbikqyrës të dokumentave që i paraqiten asamblesë.

Hartimit nga këshilli mbikqyrës i raportit për vlerësimin e auditimit të pasqyrave financiare.

Planifikimit të të ardhurave të shoqërisë të detajuar sipas burimit të krijimit.

Planifikimit të shpenzimeve dhe shpërndarjes së fondeve duke pasur parasysh kërkesat dhe realizimin e tyre në vitin e mëparshëm.

Planifikimit në zë të veçantë të pagesës e këshillit mbikqyrës dhe saktësi në planifikim të llogaritjes së kontributeve shoqërore e shëndetsore të punëdhënësit, në masën 16.7% mbi fondin e pagës bruto.

Parashkrim i qartë në nenet e kontratës, për subjektet “Ina Toci” dhe “ISTC media”, që ka lidhje me arkëtimin e të ardhurave me vlera më të vogla se 1000 lek.

Pagesës së qirasë për subjektet qiramarrëse në afatet e përcaktuara në kontrata dhe aplikimin e penaliteteve në të gjitha rastet e pagesës me vonesë të tyre, kamatën ditore në masën 1% për çdo ditë vonesë ditore, mbi vlerën e qerasë mujore.

Dokumentimit të monitorimit të zbatimit të kontratave, pasi nuk është mbajtur proces verbal gjatë kontrollit të detyrimeve kontraktore për cilësinë e kërkuar sipas specifikimeve teknike e dokumentacionit të tenderit.

Rregjistrimit në ditarët e kontabilitetit të të gjithë elementeve që përcakton ligji për kontabilitetin.

Hartimit të rregjistrimit të aktiveve.

Hartimit të rregullave për menaxhimin e aktiveve.

Plotësimin të rregjistrimit themeltar dhe librit të pagave për punonjësit e shoqërisë.

- *Sisteme të tjera me karakter organizativ nëpërmjet*

Përditësimin të rregullores së funksionimit të drejtorisë së financës në lidhje me detyrat e përgjegjësitë e cdo punonjësi për detyrimet financiare të prapambetura.

Përcaktimit në mënyrë të qartë të arsyeve për detyrimet e prapambetura, të pashlyera përpara vitit 2019 dhe planifikimin me përparësi të shlyerjes së tyre.

Respektimit me saktësi në shlyerjen e detyrimeve të prapambetura sipas parimit të radhës kohore të krijimit të detyrimeve, pasi në rastin e Mbetjeve të përziera, fatura e muajit janar 2020 është likuiduar më parë se fatura e muajit dhjetor 2019, që rezulton në listën e detyrimeve e palikuiduar.

Dërgimit në APP të kërkesës për përjashtimin e kontraktorit nga pjesëmarrja në prokurimet publike brenda 3 (tre) muajve nga zgjidhja e kontratës, në rast të mospërbushjes së detyrimeve kontraktore, të zbatohet Neni 77, Kreu IX, VKM 914/2014 dhe pika 3/ç e nenit 13 LPP për vendosje penalteti. Mbajtjen e sigurimit të kontratës në rast moszbatim kontrate nga kontraktori dhe në rast shtyrje të afatit të zbatimit të kontratës, mbulimin me sigurim kontrate të shtyrjes së afatit të deklaruar të kontratës.

Miratimit të rregullave për lëvizjen e shkresave nëpërmjet zyrës së arkivit të ndërmarrjes, në zbatim të detyrimeve ligjore të ligjit nr. 9154, dt.06.11.2003 “Për arkivat” dhe “Normave tekniko-profesionale dhe metodologjike të shërbimit Arkivor në Republikën e Shqipërisë”, të përcaktuara nga Drejtoria e Përgjithshme e Arkivave.

- *Sisteme të tjera nëpërmjet*

Njoftimit të donatorit, ambasadës japoneze, për përfundimin e ekzekutimit të projektit ng NSHP.

• **Përgjigja dhe reagimet e menaxhimit**

Për vitin 2020 janë propozuar gjithësej 52 rekomandime, nga të cilat :

- ✓ Për përmirësimin e sistemeve janë propozuar 46 rekomandime, të cilat janë pranuar plotësisht nga menaxhimi. 22 rekomandime janë realizuar dhe 24 janë në proces për arsye kryesisht, të njohjes së strukturave me bazën ligjore, të zbatimit të tyre në punën dhe dokumentacionin e vitit 2021, të plotësimit të strukturave me punonjësit e miratuar dhe të bashkërendimit të punës midis strukturave.
- ✓ Me karakter organizativ është propozuar 5 rekomandime, të cilat janë pranuar plotësisht nga menaxhimi. 0 rekomandime janë realizuar dhe 5 janë në proces për arsye se, i takojnë angazhimit të fundit të auditimit, do të zbatohen në vitin 2021.
- ✓ Rekomandime të tjera janë propozuar 1, të cilat janë pranuar plotësisht nga menaxhimi dhe është realizuar.

Për zbatimin e rekomandimeve të vitit 2019, nga 22 rekomandime të raportuara në proces zbatimi, gjatë vitit 2020 është verifikuar se janë zbatuar edhe 13 prej tyre, duke mbetur në proces zbatimi vetëm 9 rekomandime që mbeten për verifikim në auditimin e radhës të subjekteve përkatëse.

Drejtimi ka planifikuar punën për ndjekjen e rekomandimeve të auditimit me angazhime auditimi specifike, për tu siguruar se njësitë kanë ndërmarrë të gjitha masat ose veprimet e duhura për zbatimin e rekomandimeve apo masave korigjuese e këshillave të auditimit.

Duke e vlerësuar të rëndësishëm dhe qëllim final të auditimit zbatimin e rekomandimeve, në vijim do vijojë bashkëpunimin me njësitë e audituara, me qëllim që :

- Rekomandimet të jenë të qarta, të plota, dhe të ndihmojnë subjektin në përmirësimin e punës dhe ndreqjen e parregullsive.
- Rekomandimet të diskutohen dhe pranohen që gjatë fazës së përgatitjes së Projekt raportit të auditimit, duke rënë dakord për përfshirjen e tyre në Raportin Përfundimtar të auditimit.
- Të diskutohet dhe bashkëpunohet me subjektet e audituara mbi planin e veprimit paraprak.
- Rekomandimet e AB të përfshihen në rregjistrin e riskut të subjektit dhe të bashkisë si ngjarje që rrezikojnë realizimin e objektivave.
- Të respektohet afati ligjor i raportimit të masave të marra nga subjekti i audituar.
- Caktimin e një zyrtari përgjegjës për ndjekjen dhe raportimin e realizimit të tyre.

VI. Monitorimi i Sistemit dhe Sigurimi i Cilësisë

Struktura audituese është përpjekur të kryejë monitorimin e sistemit dhe sigurimin e cilësisë në të gjitha fazat e kryerjes së auditimit, pra që në planifikim, zbatim dhe raportim. Sigurimi i cilësisë është bërë nga drejtuese e njësisë, nëpërmjet plotësimit të formateve standarte për të gjitha fazat me informacion cilësor, sipas *Programit për sigurimin e brendshëm të cilësisë të AB* për bashkinë Korçë, miratuar me urdhërin e kryetarit të bashkisë nr.647, dt.17.10.2018.

Në fund të vitit 2020 Drejtoria i është nënshtruar kontrollit të cilësisë nga jashtë nga DHAB.

Reagimet e marra nga pala e audituar janë pjesë e dosjes së auditimit dhe janë mbajtur parasysht për përmirësimin e punës audituese. Janë përgatitur formularët e kontrollit të cilësisë sipas Manualit të ri.

VII. Analiza e Kapaciteteve Audituese

• Probleme të konstatuara në lidhje me funksionimin e NJAB

Problematikat e punës audituese, të evidentuara gjatë vitit 2020 kanë qënë :

- Përditësimi i njohurive më kërkesat e Manualit të ri për AB kërkon kohë dhe trajnim të specializuar.
- Mungesa e plotësimit të strukturës së AB me minimumi 3 auditues.
- Vështirësitë e shkaktuara nga pandemia COVID-19.
- Nuk është krijuar Komiteti i Auditimit të Brendshëm.

- **Kapacitetet audituese**

Drejtoria e auditimit në Bashki ka strukturë : 1 Drejtor, 3 Specialistë, gjithsej 4 punonjës.

Për vitin 2020 kanë punuar 2 audite. Të dy punonjëset janë të pajisur me çertifikatën e AB në sektorin publik.

Vartësia e njësisë së auditimit është nga Titullari i Institucionit (Kryetari).

Arsimi profesional i punonjësve është: 1 ekonomiste finance dhe 1 ekonomiste plani, në përputhje me kriteret e përcaktuara me përshkrimet e vendeve të punës që aplikohet për strukturat e auditimit. Niveli profesional i drejtores dhe i një auditeje është shumë i mirë.

Burimet e auditimit janë përdorur në përputhje me planifikimin.

- **Zhvillimi i aftësive dhe ngritja nivelit profesional të audituesve**

Drejtores e drejtorisë dhe një audite kanë ndjekur trajnimin e vijueshëm të detyrueshëm online për vitin 2020, në periudhën nëntor dhjetor 2020. Ky trajnim u zhvillua online nga DHAB.

- **Analiza e kostos dhe shpërndarja e burimeve**

Kosto në fakt e auditimeve për vitin 2020, në mijë lekë, përfshin:

Paga dhe sigurime shoqërore	2.103 mijë lekë
Dieta	60 mijë lekë
Te tjera kancelari, bojë	<u>30 mijë lekë</u>
Gjithësej kosto vjetore	2.193 mijë lekë

Burimet janë shpërndarë : 382 ditë pune për 2 persona, mesatare 191 ditë pune për person.

VIII. Konkluzione

- **Konkluzione mbi problematikën e punës audituese**

Rezultatet e këtij raporti mbështesin konkluzionin për problematika të hasura gjatë punës audituese kryesisht tek :

- Vendosja dhe miratimi i rregullave të MFK.
- Vendosja e objektivave konkrete për çdo fushë të veprimtarisë së bashkisë.
- Identifikimin e risqeve dhe përgatitja e regjistrit të riskut.
- Hartimi i strategjisë së menaxhimit të riskut.
- Përditësimi i rregulloreve të brendshme.
- Listat e proceseve të punës dhe përshkrimi i detyrave e përgjegjësive, duke përmbushur të gjitha funksionet ligjore.
- Vendosjen e aktiviteteve të kontrollit për informimin, komunikimin dhe monitorimin e veprimtarisë.
- Hartimin e regjistrave të aktiveve, përditësimin e tyre.
- Gjurmët specifike të auditit për menaxhimin e aktiveve.

Problematikat e hasura janë vlerësuar nga audituesi si fushat më me rrisht dhe janë trajtuar duke u kushtuar më shumë kohë.

Janë realizuar 6 angazhime auditimi për vitin 2020, nga 6 të planifikuara. Janë të evaduar 5 auditime dhe 1 angazhim është në proces.

Mbi bazën e raporteve finale të auditimit dhe planit të masave ka filluar puna për zbatimin e rekomandimeve e detyrave të anagazhimeve të auditimit.

• Prioritetet për vitin në vazhdim

1. Plotësimi i njësisë me personel të aftë në fushën auditimit.
2. Zbatimi i rekomandimeve të adresuara nga auditimi i Bashkimit European për veprimtarinë dhe kapacitetet e AB në sektorin public.
3. Zbatimi i rekomandimeve të dhëna nga grupi i punës i DHAB për vlerësimin e jashtëm të cilësisë.
4. Përmirësimi i procesit të zbatimit të rekomandimeve të auditimit. Kjo kërkon nga njësiti e audituara, caktimin e një anëtari të stafit të ngarkuar me ndjekjen procesit në tërësi në lidhje me :
 - Sigurimin që sistemi i bashkëpunimit të ndjekjes së rekomandimeve të auditimit është i dokumentuar dhe në mënyrën e duhur.
 - Sigurimin se është kthyer përgjigje në kohën e duhur dhe për të gjitha rekomandimet e dhëna nga auditimi.
 - Sigurimin për marrjen e të gjitha veprimeve korigjuese në zbatim të rekomandimeve.
 - Zgjidhjen e të gjitha mosmarëveshjeve që lidhen me çështjet e auditimit.
5. Përditësimi i dosjeve të përhershme të subjekteve.
6. Kryerja e auditimeve me nivel të lartë profesional, rritja e cilësisë së raportimit, rritja e nivelit profesional duke realizuar qëllimet dhe objektivat vjetore dhe strategjike.
7. Shërbime Këshillimi për drejtori të bashkisë dhe subjektet e audituara, gjatë gjithë vitit.
7. Ndjekjen e trajnimeve për ngritjen profesionale të audituesve.

Athinulla TREBICKA

Drejtuese e Njësisë

Korçë; 15 shkurt 2021